
	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E RAHOVECIT OPSTINA ORAHOVAC MUNICIPALITY OF RAHOVEC	
---	--	---

Për:	Operatorë Ekonomik: Grandelite L.L.C me adresë në Prishtinë Operatorëve Ekonomik Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	06.08.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.1) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **Kërkesës për Rishqyrtim**, të datës: **06.08.2024**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik: **Grandelite L.L.C** me adresë në **Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **FURNIZIMI ME DRU AHU PËR NEVOJAT E KOMUNËS**, me Numër të prokurimit: **623-24-6463-1-1-1**, Numër i brendshëm: **623-24-046-1-1-1**, nxjerr:

VENDIM

- I. **REFUZOHET** si e pa bazuar kërkesa e parashtruar nga Operatori Ekonomik: **Grandelite L.L.C** me adresë në **Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **FURNIZIMI ME DRU AHU PËR NEVOJAT E KOMUNËS**, me Numër të prokurimit: **623-24-6463-1-1-1**, Numër i brendshëm: **623-24-046-1-1-1**, kundër Njoftimit për Kontratë, të datës: **03.07.2024**, të publikuar në ueb-faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>
- II. Autoriteti Kontraktues vendos të vazhdoj me Njoftimin për Kontratë për aktivitetin e prokurimit: **FURNIZIMI ME DRU AHU PËR NEVOJAT E KOMUNËS**, me Numër të prokurimit: **623-24-6463-1-1-1**, Numër i brendshëm: **623-24-046-1-1-1**
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

ARSYETIM

Operatori Ekonomik: **Grandelite L.L.C** me adresë në **Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **FURNIZIMI ME DRU AHU PËR NEVOJAT E KOMUNËS**, me Numër të prokurimit: **623-24-6463-1-1-1**, Numër i brendshëm: **623-24-046-1-1-1**, kundër Njoftimit për Kontratë, të datës: **03.07.2024**, të publikuar në ueb-faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: **06.08.2024**, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042.

Pretendimet Ankimor te Kërkesat e Dosjes së tenderit dhe Njoftimit për kontratë nuk qëndrojnë ngase përcaktimi i këtyre kriterëve, të këtyre kërkesave ka të bëjë lëndën së natyrës së tenderit në fjalë, dhe gjithashtu kërkesat të tillë janë të domosdoshme për Aktivitetin e Prokurimit në fjalë.

Bazuar në të dhënat e lartë përmendura, Autoriteti Kontraktues gjatë përcaktimit të kërkesave dhe dëshmimeve është kujdesur që në maximum ti respektoj parimet thelbësore të përcaktuara me LPP siç janë, **Konkurrenca, Trajtimi i barabarte dhe jo diskriminim**. Gjithashtu Autoriteti Kontraktues është kujdesur që të vendos vetëm kërkesa dhe dëshmi në **pajtueshmëri me objektin e kontratës**. **Kërkesat e vendosura në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë** janë vendosur gjithashtu duke u bazuar plotësisht në nenin 69 paragrafin 6.1 dhe paragrafin 6.4 të Ligjit të Prokurimit Publik

Autoriteti Kontraktues konsideron se kërkesa e AK-së janë relevante dhe proporcionale me natyrën e kësaj kontrate dhe kushteve/rrethanave reale që do hasen nga implementuesit e kontratës, rrjedhimisht konsiderojmë se pretendimet ankimorë janë të pabazuar.

Nga konstatimet e lartcekur u vendos si në dispozitive të këtij Vendimi.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik ne Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij **vendimi të AK-së ju munde të paraqitni** ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

Vendimi Publikohet:

Në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

Astrit Mullabazi
Menaxher i Zyrës se Prokurimit
Komuna e Rahovecit